




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KTV
Berat BICAJ
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2020/49 - z. Faton Thaçi (Palë Ankuese) kundër
KTV (Palë Përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 17 prill 2020 ka pranuar një ankesë nga Pala Ankuese ndaj kronikës “Shpronësimet në Malishevë”, të transmetuar në edicionin e lajmeve qëndrore të datës 1 prill 2020. Përmes ankesës Pala Ankuese pretendon se: Në kronikën “Shpronësimet në Malishevë” janë prezentuar lajme të pabazuara në fakte duke apostrofuar emrin tim kinse si person nën hetime dhe duke bërë kështu gjykim publik gjë që më ka shqetësuar mua dhe familjen time, duke dëmtuar dhe degraduar rëndë autoritetin njëzror, human dhe intelektual”.
3. KPM me datën 21 prill 2020, përmes një shkrese e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me ankesën.
4. KPM brenda afatit ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse përmes së cilës theksojnë se kronika e transmetuar nuk duhet paragjykuar pasi që nuk është bërë me ndonjë qëllim të keq për t'i shkelur të drejtat dhe reputacionin e palës ankuese para publikut të gjërë, por me informimin e publikut lidhur me çështjet që kanë karakter të interesit publik.
5. KPM ka analizuar ankesën e Palës Ankuese, si dhe ka monitoruar kronikën e lartpërmendur dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 27 prill 2020 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 28 prill 2020 i ka dërguar Palës Ankuese Njoftim për Shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar që në afat prej shtatë (7) ditëve t'i ofrojë Palës Ankuese mundësinë për reagim lidhur me kronikën e transmetuar në edicion e lajmeve në KTV të datës 1 prill 2020.
7. KPM me datën 12 maj 2020 ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse ndaj Njoftimit për Shkelje, me të cilën përgjigje Pala Përgjegjëse thekson se kanë provuar disa herë të kontaktojnë me Palën Ankuese, mirëpo nuk i është përgjigjur duke cekur se nuk qëndrojnë pretendimet e Palës Ankuese se nuk i është ofruar e drejta e reagimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM -2016/03.

Analiza Ligjore

8. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton:

“Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një ofrues të shërbimit media për të cilin faktet janë bërë të disponueshme për publikun të cilat ai i deklaron që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që shqetësojnë atë person”.

9. Sipas nenit 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 çdo person pa dallim shtetësie ose vendbanimi kur i përmendet emri nga OSHMA-të dhe faktet të cilat i bëjnë të disponueshme për publikun dhe për të cilat fakte personi i deklaron se janë të pasakta, ky person mund ta shfrytëzojë të drejtën e reagimit, ashtu siç përcaktohet me nenin e lartpërmendur.
10. Përkundër faktit se në Përgjigjen e Palës Përgjegjëse ndaj Njoftimit për Shkelje të dërguar nga Zyra Ekzekutive e KPM-së theksojnë se kronika nuk ka pasur qëllim të keq për t'i shkelur të drejtat dhe reputacionin e Palës Ankuese para publikut të gjerë dhe se kanë provuar disa herë të kontaktojnë me Palën Ankuese, mirëpo nuk i është përgjigjur duke cekur se i kanë ndërmarrë veprimet dhe nuk qëndrojnë pretendimet e Palës Ankuese pasi që nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03. KPM ka bërë vlerësimin e përgjigjës së Palës Përgjegjëse dhe bazuar në Raportin e monitorimit konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar t'ia japë të drejtën e reagimit Palës Ankuese edhe përkundër kërkesës së Palës Ankuese për ta shfrytëzuar këtë të drejtë, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
11. Komisioni i KPM-së konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të marr hapat e nevojshëm për të vepruar në pajtueshmëri me nenit 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim

12. Pala Përgjegjëse sanksionohet me *Vërejtje* në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë.
13. Pala Përgjegjëse obligohet që në afat prej shatë (7) ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, t'i ofrojë Palës Ankuese të drejtën e reagimit në hapësirë të njëjtë dhe në kohë të njëjtë, në mënyrë që të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

14. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjrisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



30.10.2020
Datë